

VENDIM
Nr.515, datë 30.7.2004

PËR LEJIMIN E INSTITUCIONEVE BUXHETORE TË PËRDORIN PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR BLERJE GAZOILI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e institucioneve buxhetore, që, për fondet limit të miratuara në buxhetin e vitit 2004, të paprokuruara, për të cilat nuk është shpallur fituesi deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përdorin procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “ARMO” sh.a. Fier, për blerje gazoili, STASH 31:1997(D-2), të ndarë sipas loteve dhe çmimeve si më poshtë vijon:

- Gazoil STASH 31:1997 (D-2) për furnizimin e automjeteve me tolona, me çmimin 68 (gjashtëdhjetë e tetë) lekë/litër.

- Gazoil STASH 31:1997 (D-2) për furnizimin e automjeteve me autobote, me çmimin 64 (gjashtëdhjetë e katër) lekë/litër.

2. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano